



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:016957
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05869390

K.DH.SH.II.nr.982/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kuvilabi SHPK me NUI810324059 me seli ne fshatin Bardhosh-Prishtinë te cilin e përfaqëson Ilir Gashi avokat me seli ne Prishtinë, ndaj debitorit Andi Group 2004 SHPK me NUI 811291046 me seli ne Gjilan te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdulla Gashi, bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit për shtyrje te përmbarimit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.949/23 të datës 26.03.2024, me datën 27.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit për shtyrje te përmbarimit Andi Group 2004 SHPK me NUI 811291046 me seli ne Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.949/23 të datës 26.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.949/23 të datës 26.03.2024, është shpall Jo kompetent ne pikëpamje lëndore për te vendosur sipas kërkesë Andi Group 2004 SHPK, për shtyrje te përmbarimit në lenden përmbarimore sipas Urdhrit P.nr.189/23, të datës 09.06.2023, të Përmbaruesit Privat Mujesere Mujku. Hedhtë poshtë si e palejueshme kërkesa e debitorit ‘‘Andi Group 2004 SHPK për shtyrje te përmbarimit në lenden përmbarimore sipas Urdhrit P.nr.189/23, të datës 09.06.2023 të Përmbaruesit Privat Mujesere Mujku.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe shkeljes

se te drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar te ndryshojë te shtyje përbarimin për periudhën prej 6 muaj deri 10 muaj nga dita e aprovimit te kërkesës për shumën ne lartësi prej 4145.31€ te lejuara me Urdhrit Përbarimor P.nr.189/23, të datës 09.06.2023 të Përbaruesit Privat Mujesere Mujku.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave te përshkuar ne Urdhrin përbarimor. Përbaruesi privat, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.189/23, të datës 09.06.2023, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t'i paguaj shumën 4145.31€,

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim, me te cilin ka kundërshtuar Urdhrin për përbarim. Kreditori me përgjigje ne prapësim e ka kundërshtuar prapësimin dhe ka kërkuar nga gjykata qe te refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar, e është shpall Jo kompetent ne pikëpamje lëndore për te vendosur sipas kërkesë Andi Group 2004 SHPK, për shtyrje te përbarimit në lenden përbarimore sipas Urdhrit P.nr.189/23, të datës 09.06.2023, të Përbaruesit Privat. Hedhtë poshtë si e palejueshme kërkesa e debitorit ‘‘Andi Group 2004 SHPK për shtyrje te përbarimit në lenden përbarimore sipas Urdhrit përbarimore P.nr.189/23, të datës 09.06.2023 të Përbaruesit Privat. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së propozimi për shtyrje të përbarimi është palejuar në baze te neni 61 LPP. Andaj marrë parasysh këto gjykata e shkallës e pare ka vendosë si ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur gjykata e shkalles e pare është shpallur jo kompetent dhe ka hedhe poshtë si te palejueshme kërkesën për shtyrje te përbarimit te urdhrin të përbaruesit privat, me të cilin është caktuar përbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate dhe në mbështetje të nenit 61 paragrafi 1 te LPP-së, përcaktohet *Shtyrja e përbarimit sipas kërkesës së debitorit 1. Në qoftë se debitori argumenton se zbatimi do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm, organi përbarues plotësisht ose pjesërisht do të shtyjë përbarimin kur: 1.1. është parashtruar ankesë kundër dokumenti përbarues dhe pala ankuese i demonstroi Gjykatës së shkallës së parë se ka mundësi bindëse për të qenë e suksesshme në ankesë, apo 1.2.*

Gjykatës i është parashtruar kërkesa për të anuluar një vendim të arbitrazhit në pajtim me Ligjin për Arbitrazhin. 2. Dorëzimi i kërkesës për shtyrje të përmbarrimit nuk shtyn zbatimin e përmbarrimit. 3. Para lejimit të shtyrjes së përmbarrimit, organi përmbarrues do t'i sigurojë kreditorit të drejtën që të deklarohet në lidhje me të dhe të jep dëshmi në kundërshtim të shtyrjes. 4. Organi përmbarrues mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbarrimin në situata ku debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbarrimi do t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumë e kërkesës. Nga përmbajtja e dispozitave ligjor ete lartecëkura kuptohet se kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje të përmbarrimit është organi përmbarrimor, përkatësisht Përmbarruesi privat i cili kja lejuar urdhrin përmbarrimor, ndërsa përjashtimisht, në kuptim të nenit 61 pika 11 LPP-se gjykata është kompetent në rast kur vepron si organ përmbarrimor dhe ka juridiksion për të vendosur në ankesë kundër urdhrin përmbarrimor.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.982/24, me datë 27.06.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi